



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KONTRATA

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E PRISHTINËS**

dhe

Emri i Kontraktuesit: **Grupi i Operatorëve Ekonomik "L-Group" sh.p.k. dhe N.N.P. "ISA DEKOR"** me lider **"L-Group" sh.p.k.** nga Prishtina me adresë: *Imzot Nikë Prela, D9-IV, nr.15*, me nr. të regjistrimit të biznesit 70993589 dhe nr. fiskal 601020126, përfaqësuar nga: Lirim Krasniqi – Drejtor janë pajtuar si në vijim për:

TITULLI I KONTRATËS: Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse.

Numri i Prokurimit: 616 18 58 236

Neni 1 Ligji i zbatueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-03/L-241. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë.

Neni 2 Lënda

2.1 Lënda e kontratës duhet të jetë **Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse, (kryerja e sherbimeve)**, sipas specifikimeve teknike që janë pjesë e kësaj kontrate në afatin kohor prej 30 ditëve.

2.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar].

2.3 Sherbimet – të cilat përbëjnë lëndën e kontratës duhet të shoqërohen me pjesë rezervë të përshkruara nga Kontraktuesi në Kuotimin e tij dhe nga [pajisjet shtesë / artikujt tjerë të nevojshëm për shfrytëzimin e mallrave gjatë një periudhe prej:[.....],siç është e specifikuar në instruksionet për Tenderuesit].

2.4 Vendi i realizimit të **sherbimeve** do të jetë: në Prishtinë sipas specifikimit teknik të dhenun në dosjen e tenderit - procedura e kuotimit të çmimit. Periudha e kryerjes së sherbimeve do të vazhdojë prej datës së nënshkrimit të kontratës nga ana e të dy palëve në afatin prej 365 ditëve apo një vit me mundësi vazhdimi.

2.5 Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i sherbimeve që duhet të paguhet nga Autoriteti Kontraktues është **5,900.00 € (pesëmijë e nëntëqind euro)**

3.2. Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës.

3.4 Pagesa Kontraktorit do ti bëhet në llogarinë e tij bankare pas përfundimit të shërbimeve me konstatim të personit ose personelit të autorizuar se shërbimet janë kryer sipas kërkesës dhe dorëzimit të faturës në një afat brenda 10 ditësh.

Neni 4 Origjina

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Që shërbimet të kryhen në vendet e caktuara nga Autoriteti kontraktues, kontraktori duhet ti paguaj të gjitha pagesat dhe tatimet e zbatueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Neni 6 Dorëzimi

6.1 Kryerja e shërbimeve do të bëhet në kohën, vendin dhe mënyrën siç është specifikuar në dosjen e tenderit dhe në kushtet e kontratës, sipas kërkesave nga zyrtari i autorizuar i Komunës. Periudha e kryerjes së shërbimeve do të vazhdojë prej datës së nënshkrimit të kontratës nga ana e të dy palëve në afatin prej **30 ditëve**.

6.2 Nga dita e nënshkrimit të kontratës nga ana e të dy Palëve në afatin prej 30 ditëve por jo të tejkalohet vlera e parashikuar e kontratës.

6.3 Kontraktuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me kryerjen shërbimeve për: **Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse.**

6.4 Kontraktori është përgjegjës për dëmet eventuale të shkaktuara në njerëz dhe objekte tjera gjatë kryerjes së shërbimeve që janë objekt i kësaj kontrate.

6.5 Për dëmet eventuale të shkaktuara të cekura më lart kontraktori duhet të kompenzoj me shpenzimet e tij çdo dëmtim, humbje, lëndim apo vdekje.

Neni 7 Variacionet

7.1 Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën që, në kohën e kontraktimit, t'i ndryshojë sasi të parapara në Kushtet e veçanta. Vlera totale e shërbimeve - mund të mos rritet dhe as të bjerë si rezultat i variacionit të sasive për më tepër se [10 %] të çmimit të kontratës. Çmimet e njësisë që janë përdorur në ofertë do të zbatohen edhe për sasi të prokuruar me variacion.

Neni 9 Garancia

9.1 Kontraktuesi do të garantojë që shërbimet të jenë në pajtim me specifikimet teknike dhe me përshkrimet dhe kërkesat tjera të dosjes së tenderit dhe të formularit të tenderit.

Neni 10 Vonesat e ekzekutimit

10.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrinë t'i realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit,

Neni 9 Garancia

9.1 Kontraktuesi do të garantojë që shërbimet të jenë në pajtim me specifikimet teknike dhe me përshkrimet dhe kërkesat tjera të dosjes së tenderit dhe të formularit të tenderit.

Neni 10 Vonesat e ekzekutimit

10.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrinë t'i realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.

Neni 11 Inspektimi dhe testimi

11.1 Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në Kushtet e veçanta.

Neni 12 Nën-kontraktimi

12.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 5 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Nuk mund të nënkontraktuj më tepër se 40 % të vlerës së kontratës.

Neni 13 Pagesat

13.1 Pagesat do të bëhen në - euro pas përfundimit të shërbimeve - me konstatim nga personat e autorizuar se shërbimet për: **Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse** janë bërë sipas kërkesave të paraqitura në dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda [30] ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme.

Neni 14 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

14.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Kontraktuesit **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur kontraktuesi nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d). Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Kontraktuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës; i) Nuk arrinë të jap garancinë për funksionim të mirë të mallrave.

Neni 15 Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit

15.1 Kontraktuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues **14 ditë** paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Kontraktuesit shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) E pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se [180] ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Kontraktuesit.

Neni 16 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

16.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda [30] ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi nga gjykata kompetente.

Neni 17 Komunikimet

17.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

E hartuar në gjuhën [shqipe] dhe [serbe]¹ në katër origjinale, tri për Autoritetin Kontraktues dhe një për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	<i>pp</i> Zekë Bardhaj <i>NEXHMI ME NEKOLLI</i>	Emri:	LIRIN KRASHIÇI
Pozita:	Drejtor i Prokurimit	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi		Nënshkrimi:	
Data:	07.06.2018	Data:	07.06.2018
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në këtë tender.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: Caktohet me Vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ
Vlera e Kontratës		5880,00 € (pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro) për 30 ditë, por ka ndodhur një gabim në paramasë në pikën 1.1. ku çmimi për njësi është 100 euro, ndërsa shuma totale e njësisë 80 euro dhe në këtë rast mbizotëron çmimi njësi dhe vlera e ofertës është 5,900.00 € (pesë mijë e nëntëqind euro)
Siguria e ekzekutimit	14.1	590,00 € (pesëqind e nëntëdhjetë euro) për 60 ditë
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë b) Përgjegjësia e pales së tretë c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve d) Përgjegjësia profesionale e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Pagesat		Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e veçanta të kontratës. Meqenëse realizimi i shërbimeve do të bëhet në afat prej 30 ditëve. Pagesat do të bëhet në tërësi
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Nga Menaxheri i Projektit Periudha e përgjegjësise së Defekteve është
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Me anë të ndërmjetësit nga Autoriteti Kontraktues dhe Palës kontraktuese
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. Ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Numri i Prokurimit: 616 18 58 263 – Titulli Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse

PJESA C: FORMULARI I PARAOITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr 616-18-2888-2-3-6. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

5880,00

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: [shëno çmimin e përgjithshëm në shifra €]

pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro.

Dhe me shkrim [shëno çmimin e tenderit me shkrim Euro]

3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej 60 ditë nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme të cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

DORËZUAR NGA:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	"L-GROUP" - SH.P.K.
ADRESA E PLOTË	PRISHTINE
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	LIRIIT KRASHI/RI
POZITA	DREJTOR
NENSHKRIMI	<i>[Signature]</i>
DATA	07.05.2018
VULA	



Numri i Prokurimit: 616 18 58 263 – Titulli Pastrimi i ambienteve të trashëgimisë në objektin e ish-konsullatës dhe objektet përcjellëse

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Të bashkëngjitur gjeni përshkrimin e çmimeve në sistem elektronik të e-prokurimit.

Përshkrimi për punët e pastrimit, Interevenimit me qëllim të mbrojtjes së strukturave ndërtimore në ndërtesat: 'Shtëpi banimi - Fitim Gjata' dhe 'Shtëpi banimi - Imer Berisha', si dhe krijimin e kushteve për dokumentim të gjendjes ekzistuese.


Paramasa dhe paralogaria

Punët e pastrimit, demolimit dhe përforcimit

Përshkrimi		Sasia	Njësia	Çmimi	Shuma
1					
1.1	Vendosja e tri tabelave informuese me shënjëzimet e nevojshme.	paushall	paushall	€ 100.00	€ 80.00
1.2	Vendosja e rrethojës mbrojtëse për zhvillimin e punimeve. Rrethoja të punohet nga llamarina e valëzuar, përgjatë pjesës ballore të fasadave në gjatësi prej 35m, lartësi 2m dhe e larguar nga fasada rreth 1.5m. pjesë e rrethojës të punohen edhe dyert me gjerësi të krahut 1.5m, me të gjithë mekanizmin përcjellës. Në çmim të parashihet edhe konstruksioni i drurit me të gjitha përforcimet për llamarinë dhe ankerimet në tokë. Realizimi i këtyre punëve të kryhet sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës.	70	m ²	€ 30.00	€ 2,100.00
1.3	Pastrimi i ndërtesave dhe oborreve, nga kolonizimi bimor. Në çmim përfshihet prerja, tharja e bimësis me kemikate për tharje sipas udhëzimit të organit mbikëqyrës, si dhe grumbullimi dhe transporti deri në deponi legale.	20.00	m ³	€ 15.00	€ 300.00
1.4	Demolimi i pjesëve të dëmtuara, të shkëputura të ndërtesave, të cilat paraqesin rrezik gjatë zhvillimit të punimeve Demolimi të bëhet me kujdes të shtuar, për shkak të rrezikshmërisë së lartë dhe statusit ligjor të ndërtesave, sipas udhëzimeve dhe mbikëqyrjes së organit mbikëqyrës.	1.00	paushall	€	€ 100.00
1.5	Seleksionimi, pastrimi dhe vendosja e materialit ndërtimor që mund të ripërdoret. Materiali i shëndosh ndërtimor do të vendoset në një pjesë të oborrët. E gjithë procedura realizohet sipas udhëzimit të organit mbikëqyrës.	1.00	paushall	€ 300.00	€ 300.00
1.6	Pastrimi, grumbullimi dhe ngarkimi i mbeturinave, materialit inert si dhe transporti deri në deponi legale, sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës.	400.00	m ³	€ 5.00	€ 2,000.00



[Handwritten signature]

1.7	Furnizimi edhe realizimi i përforcimeve me traje të drurit, me dimensione 10x12cm. Në çmim të parashihen të gjitha elementet përcjellëse. Realizimi i përforcimeve kryhet sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës.	1.50	m ³	€ 200.00	€ 300.00
1.8	Furnizimi dhe realizimi i përforcimeve me drrasa të drurit, me trashësi 5cm. Në çmim të parashihen të gjitha elementet përcjellëse. Realizimi i përforcimeve kryhet sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës.	2.00	m ³	€ 250.00	€ 500.00
1.9	Punë të paparapara	1.00	payshall	€ 200.00	€ 200.00
TOTALI					
Identifikimi i Operatorit Ekonomik					
Emri i Kompanisë	"L. DEKOR" SH.P.K.				
Adresa e Plotë	PRISHTINE				
Perfaqesuar Nga:	E				
Emri	LIRI KRASTIĆI				
Pozita	DREJTOR				
Nenshkrimi	<i>[Signature]</i>				
Data	02.01.2018				
Vula					



[Handwritten signature]